



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

**PËR PROVIMIN E DIGJITALIZUAR PËR PUNËSIMIN SI TEKNIK I SHKENCAVE
MJEKËSORE**

Ju bëjmë me dije se gjatë periudhës Nëntor – Dhjetor 2024, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), do të zhvillohet provimi i digjitalizuar për punësimin si teknik i shkencave mjekësore.

Së shpejti, në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al, do të publikohet kalendari i organizimit të provimit sipas profesioneve, si dhe orari i pjesëmarrjes në provim për çdo kandidat.

1. Kandidati duhet të paraqitet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:

- Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
- Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
- Faturën origjinale të pagesës (me vulën e bankës përkatëse) së tarifës së provimit për llogari të QSHA-së. Formularin për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në linkun: https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2024/08/Fatura_shkenca_mjekesore.pdf

Kandidatët, të cilët nuk paraqesin dokumentet e mësipërme, nuk mund të marrin pjesë në provim.

2. Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:

- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
- ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit;
- firmos procesverbalin e pjesëmarrjes dhe rezultatit të marrë.

Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë ndryshime.

Lutemi që kandidatët të verifikojnë paraprakisht të dhënat në listat që do të publikohen në vijim në faqen www.qsha.gov.al dhe në rast pasaktësish t’i drejtohen OSHKSH.

Ju urojmë Suksese!